



**FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS**  
**KOSOVO ATHLETIC FEDERATION**

Web page: [www.fakosova.org](http://www.fakosova.org)

e-mail: [kos@mf.iaaf.org](mailto:kos@mf.iaaf.org)

---

## **RREGULLORE SHËNDETËSORE**

Në bazë të nenit 60 të Ligjit të sportit të Kosovës (Ligji Nr. 2003/24) dhe neni 20 të Statutit të Federatës Atletike të Kosovës, Bordi i Federatës Atletike të Kosovës, me qëllim të përmirësimit dhe mbrojtjes së shëndetit të anëtarëve të tij ka sjellë këtë:

## **RREGULLORE SHËNDETËSORE**

### ***Dispozitat e përgjithshme***

#### **Neni 1**

Rregullorja shëndetësore e Federatës Atletikës të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: FAK-u) përcakton masat dhe veprimet që lidhen me kujdesin shëndetësor dhe të kontrollit shëndetësor të anëtarëve të FAK-ut që janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në procesin e garave dhe të treningut.

#### **Neni 2**

Në të gjitha garat, të cilat janë në kalendarin e FAK-ut, dhe mbahen në territorin e Kosovës, kujdesi shëndetësor duhet të kryhet sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore, në pajtim me Ligjin e sportit të Kosovës.

### ***Ekzaminimi mjekësor sistematik dhe kontrolli***

#### **Neni 3**

Para fillimit dhe gjatë praktikimit të sportit të atletikës, çdo person i cili është i përfshirë drejtpërdrejt në procesin e garave dhe procesit të treningut është i obliguar që të bëjë një ekzaminim dhe kontroll të mjeku sportiv. Nëse për arsye shëndetësore vjen te përfundimi se personi në pyetje nuk mund të praktikoj sportin, atij nuk do të lejohet aktiviteti në procesin e treningut dhe garave.

#### **Neni 4**

Në garë sportive mund të merr pjesë atleti të cilit në periudhë prej gjashtë muajve para se të mbahet gara sportive i është vërtetuar aftësia e përgjithshme shëndetësore për të kryer aktivitete apo veprimtari sportive.

Aftësia shëndetësore e posaçme vërtetohet krahas aftësisë shëndetësore të përgjithshme për një periudhë prej 6 muajsh para mbajtjes së garës sportive tek: atletët profesionist, atletët e kategorizuar në bazë të kategorizimit kombëtar.

Duke respektuar paragrafin 2 të këtij neni, aftësi shëndetësore të posaçme të sportistëve garues nga 16 vjet duhet bërë: atletit të kategorizuar në bazë të kategorizimit kombëtar, pjesëmarrësit të kategorive të reja që garojnë në kategoritë e vjetra, kjo vërtetohet për një periudhë prej katër muajsh para se të mbahet (organizohet) gara sportive.

#### **Neni 5**

Rreth vërtetimit të aftësive shëndetësore të sportistëve garues mbahet një evidencë, nga dita e regjistrimit të parë për klubin e caktuar të atletikës, siç përcaktohet në përputhje me ligjin që rregullon evidencën në sektorin e shëndetësisë. Për garuesit bartës të bursave të FAK-ut dhe Komitetit Olimpik të Kosovës, si dhe për të gjithë garuesit të cilët komisioni profesional në propozim të selektorit i trajton (merr) si talent, dokumentacionin shëndetësor e rregullon dhe e ruan zyra e FAK-ut në përputhje me ligjin që e rregullon evidencën në lëmin e shëndetësisë.

#### Neni 6

Qëllimet e ekzaminimit të aftësive shëndetësore të atletëve garues për të marrë pjesë në gara janë ruajtja dhe përmirësimi i shëndetit dhe aftësive punuese të atletëve garues, orientimin e duhur në sport, parandalimin e sëmundjeve, lëndimeve dhe çrregullimeve të tjera shëndetësore dhe invaliditetin gjatë marrjes me sport.

Me ekzaminimet që vërtetohet aftësia shëndetësore e atletëve garues përcaktohet gjendja shëndetësore, vlerësohen aftësitë psikofizike në lidhje me kërkesat e degëve të veçanta të sportit dhe të disiplinës, si dhe ndikimin e përgjithshëm të aktivitetit fizik në organizëm dhe ofrohet një përzgjedhje të duhur në sport në bazë të përcaktimit të predispozitave në të cilat mund të presin sukses më të lartë.

#### Neni 7

Përcaktimi i aftësive shëndetësore të përgjithshme dhe të posaçme të atletëve garues realizohet përmes ekzaminimit shëndetësor të parë, periodik dhe të jashtëzakonshëm.

#### Neni 8

Ekzaminimi i parë mjekësor i garuesve bëhet para se të fillojnë praktikimin me sportet e caktuara ose para se të regjistrohet për herë të parë për një klub të caktuar të atletikës.

Me ekzaminim vërtetohen aftësinë e përgjithshme dhe të posaçme shëndetësore të sportistëve në lidhje me degën specifike atletike apo disiplinën.

Qëllimi kryesor i ekzaminimit është vërtetimi i aftësive shëndetësore për t'u angazhuar në një disiplinë të veçantë dhe orientimi në degën e atletikës dhe disiplinën në të cilën, në bazë të predispozitave, mund të presin sukses më të madh.

#### Neni 9

Ekzaminimi periodik i përgjithshëm dhe i posaçëm shëndetësor kryhen me qëllim të kontrollit të shëndetit dhe aftësive gjatë praktikimit me aktivitet të veçantë sportiv.

Me ekzaminim vërtetohen aftësinë e përgjithshme dhe të posaçme shëndetësore të sportistëve në relacion me degën konkrete të atletikës, respektivisht disiplinën.

#### Neni 10.

Ekzaminimet e jashtëzakonshme shëndetësore kryhen:

- Sipas indikacioneve shëndetësore, bazuar në ekzaminimin e parë apo periodik;
- Pas sëmundjeve të rënda dhe lëndimeve të shkaktuara gjatë aktiviteteve sportive apo për arsye të tjera;
- Në kërkesë të FAK-ut, klubit atletik, trajnerit sportiv, komisionit shëndetësor të FAK-ut, mjekut të klubit apo vet atletit;
- Tek kontrolli i gjinisë;
- Pas ndërprerjes së praktikimit me sport për më shumë se një vit;
- Pas skadimit të dënimit për shkelje të rregullave anti-doping.

Me ekzaminim vërtetohen aftësitë e përgjithshme dhe të posaçme shëndetësore të sportistëve në relacion me degën konkrete të atletikës, respektivisht disiplinën.

#### Neni 11.

Komisioni shëndetësor i FAK-ut është i obliguar të mbajë evidencë për ekzaminimet e kryera për atletët bartës të bursistëve të FAK-ut dhe KOK-ut, si dhe për ata që komisioni profesionale i FAK-ut i ka vlerësuar si talent. Klubet e atletikës janë të obliguara të mbajnë evidencë për ekzaminimet e garuesve të tyre dhe për ti njoftuar ata për afatet e ekzaminimit.

## ***Mënyra dhe vëllimi i zbatimit të ekzaminimit shëndetësorë***

### **Neni 12**

Për vërtetimin e aftësisë shëndetësore të atletit garues mbahet evidencë, me futjen e të dhënave në dokumentacionin shëndetësor, prej ditës para regjistrimit në FAK, në mënyrë siç përcaktohet në përputhje me ligjin që rregullon evidencën në lëmin e shëndetësisë.

### **Neni 13**

Kërkesën për vërtetimin e aftësive të përgjithshme dhe të posaçme shëndetësore të sportistëve garues mund ta paraqes FAK-u, respektivisht klubi atletik atleti i të cilit është anëtar garues apo vet atleti garues.

Ekzaminimet kryhen në institucionet shëndetësore të cilat janë të autorizuar për ekzaminim të sportistëve.

FAK-u, respektivisht klubi atletik që merr pjesë në sistem të garave i propozon institucionit të autorizuar shëndetësor planin e ekzaminimit shëndetësor për atletët e tij garues deri në fund të tetorit për vitin e ardhshëm.

Klubi atletik apo atleti garues dhe institucioni shëndetësor që kryen vërtetimin e aftësisë shëndetësore të sportistit garues vazhdimisht bien dakord për terminin e ekzaminimit. Atletët garues janë të obliguar t'i përmbahet terminin të rënë dakord për ekzaminim.

### **Neni 14**

Standardi (vëllimi dhe përmbajtja) i ekzaminimit shëndetësor për vërtetim të aftësisë shëndetësore të atletit garues përcaktohet në bazë të analizave profesionale të kërkesave specifike funksionale të degëve të veçanta dhe disiplinave sportive, si dhe moshës.

### **Neni 15.**

Ekzaminimet shëndetësore me të cilat vërtetohet aftësia shëndetësore e atletëve dhe pjesëmarrësve në sportin shkollor, kryhet në institucionet vijuese shëndetësore:

1. Institucionet shëndetësore të cilat në përbërjen e tyre kanë ordinanca të specializuara të mjekësisë sportive,
2. Nëse në njësinë e institucionit mjekësor lokal në përbërjen e saj nuk ka klinikë (ordinancë) të specializuar për ekzaminime sportive mjekësore me të cilat vërtetohet aftësia shëndetësore e sportistëve mund të bëhet në ordinancën e specializuar të mjekësisë interne, kardiologjisë, pediatriisë, mjekësisë së punës ose të mjekësisë së përgjithshme nga mjekët e autorizuar specialistë.

### **Neni 16.**

Për rezultatet e kryera të ekzaminimit shëndetësore dhe rezultatet e vlerësimit psikologjik të institucionit shëndetësor njoftohen:

- atleti garues i ekzaminuar,
- mjeku i klubit apo një mjek i zgjedhur,
- komisioni shëndetësor i FAK-ut për atletët të cilët janë mbajtës të bursave të FAK-ut dhe KOK-ut ose kur komisioni profesional i FAK-ut i vlerëson si talent.

Mjeku i klubit (përfaqësues) mund të marrë pjesë për të vërtetuar aftësinë e shëndetit të atletëve garues, e cila duhet kryer në përputhje me rregullat sportive.

#### Neni 17.

Secili atlet garues gjatë vërtetimit të aftësive shëndetësore për të marrë pjesë në gara duhet të ketë:

- një dokument që vërteton identitetin;
- dokumentacion mjekësor ose informacion, të mjekut të klubit për sëmundjet e mëparshme, lëndimet dhe trajtimin mjekësor;
- librezën garuese;

#### Neni. 18

Atleti – garuesi në institucionin shëndetësor, ku është caktuar një ekzaminim duhet të plotësoj pyetësonin mbi të dhënat personale dhe historinë mjekësore, jo më vonë se dy ditë para terminit të planifikuar për ekzaminim mjekësor dhe ti paraqesë pyetësonin institucionit shëndetësor ku ekzaminohet.

Pyetësoni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të përmbajë informacionet e mëposhtëm:

##### **A. Informacionet e përgjithshme:**

- 1) emri dhe mbiemri i sportistit;
- 2) numri amë i identifikimit;
- 3) numrin e telefonit;
- 4) adresa email;
- 5) adresa;
- 6) profesioni;
- 7) vendin e punës ose shkollën;
- 8) data e lindjes;
- 9) gjinia.

##### **B. Historia personale sportive:**

- 1) Organizata sportive, në të cilën atleti është i angazhuar;
- 2) Federata sportive kombëtare;
- 3) Lloji i sportit;
- 4) Disiplina sportive ose kategoria;
- 5) Trajneri;
- 6) Numri i përgjithshëm i garave në të cilat atleti ka marrë pjesë.
- 7) Frekuenca (sasia) e treningut mbi baza javore;
- 8) Suksesi sportiv.

##### **Historia shëndetësore dhe faktorët trashëgues të atletit:**

- 1) Historia shëndetësore e sportistit dhe faktorët trashëgues:
  - a) Problemet e zemrës, aritmia, sinkopë (të fikët);
  - b) Kontuzion (blanë, vend i maviosur);
  - c) Alergji, astmë;
  - d) Infeksionet e përsëritura;
  - d) Sëmundjet serioze (infektive, malinje ...);
  - f) Lëndime të mëdha, operacione, hospitalizim;
  - g) Ndërprerja e aktiviteteve sportive më shumë se një muaj.

- 2) Problemet dhe vështirësitë shëndetësore të deritanishme:
  - a) Simptoma të tilla si dhimbje - të përgjithshme (muskuj, nyje);
  - b) dhimbje gjoksi, gulçim, pulpim i zemrës, aritmi;
  - c) Marramendje, humbje e shkurtër e vetëdijes;
  - d) Si simptoma të gripit, kollë, kollitje;
  - e) Humbje e oreksit, humbje peshe;
  - f) Pagjumësi;
  - g) Çrregullimeve të sistemit tretës.
- 3) Ilaçet/suplimentet:
  - a) ilaçe specifike që sportisti momentalisht është duke i përdorë;
  - b) E miratuar nga TUE (përdorimi terapeutik i liruar (përjashtuar));
  - c) Shtesa ushqimore (suplimentet), të cilat i përdor atleti;
  - d) Edukimi në rregullat anti-doping.
- 4) Vaksinimi: Regjistrimi i statusit të vaksinimit (duke përfshirë datat), sidomos Vaksinimi kundër tetanosit dhe hepatitit A dhe B
- 5) Sëmundjet e varshmërisë (duhani, alkooli, droga, lojëra, kompjuter, celular ...)
- 6) Atletet - rregullsia dhe kohëzgjatja e ciklit menstrual, kur ishte cikli i parë dhe i fundit, aktiv - joaktiv gjatë ciklit.
  - 7) Reagimi ndaj ngarkesave fizike.
- 8) Historia familjare (1. gjenerata, p.sh., prindërit, vëllezërit e motrat):
  - a) Presioni i gjakut, goditjet cerebrale;
  - b) Sëmundje të zemrës (duke përfshirë vdekjen e papritur);
  - c) Problemet me enët e gjakut, venat të zgjeruara; trombozë venë të thellë;
  - d) Diabeti;
  - d) Sëmundja e veshkave;
  - f) Alergji, astma;
  - g) Kanceri, sëmundje të gjakut;
  - h) Dhimbje kronike të nyjeve ose muskujve;
  - i) Problemet hormonale.

Pyetëtori i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje në Formular nr. 1 dhe formon një pjesë integrale të saj.

Me pyetëSORIN e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të shoqërohet me rregullat e vlefshme sportive të Federatës Atletikës të Kosovës në lidhje me ekzaminimet shëndetësor të sportistëve, nëse ata kanë dorëzuar më parë dhe në ndërkohë ka pasur ndryshime.

Pyetëtori i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, i cili mban datën nënshkruar nga atletët garues apo prindi-kujdestari dhe mjeku i klubit nëse ekziston apo mjeku i reprezentacionit të atletëve që i përkasin kategorisë kombëtare.

#### Neni 19

Vëllimi minimal i ekzaminimit për të përcaktuar aftësinë e **përgjithshme** shëndetësore për të marrë pjesë në garat sportive përfshinë:

- 1) Marrja e informata e përgjithshme;
- 2) Lartësia;
- 3) Pesha;
- 4) Presioni i gjakut (e rekomandueshme të përdorni përherë të njëjtën krah dhe të shënoj atë në dokumentacion mjekësor të atletit);
- 5) Koka dhe qafa (mprehtësinë e të pamurit);
- 6) Nyejt limfatike;

- 7) Kraharori dhe mushkëritë (ekzaminim);
- 8) Zemra (tonet, zhurmat, frekuencat e zemrës, ritmin);
- 9) Barku (përfshirë hernia (dhjami), plagët);
- 10) Enët e gjakut (p.sh., impulset periferike, zhurmat e venave, zgjerimi i venave);
- 11) Ekzaminimi i lëkurës;
- 12) Sistemi nervor (p.sh. Refleksët, parregullsi sensorike);
- 13) Sistemit skeletal-muskulor me status postural (shtyllën kurrizore, kraharorin, ekstremitetet e poshtme dhe të sipërme);
- 14) Elektrokardiogram;
- 15) Testet laboratorike: pasqyra komplete e gjakut (hemoglobinës, hematokriti, eritrocitet, leukocitet, trombocitet), sheqeri në gjak, testet e urinës (testi i shiritit të matur për të përcaktuar nivelin e proteinave dhe sheqerit);
- 16) Echo zemra për ekzaminimin e parë të atletit;
- 17) Ekzaminime të tjera nëse kërkon komisioni shëndetësor i FAK-ut.

#### Neni 20

Volumi standard i ekzaminimit për përcaktimin (vërtetimin) e posaçëm të aftësive shëndetësore për të marrë pjesë në garat sportive krahas ekzaminimit nga neni 19 përfshinë:

- 1) ekzaminime laboratorike: sedimentimi; urea; kreatininë; aspartat amino-transferase (AST); alanin amino-transferaza (ALT); bilirubinë (totale), urina me sedimente; sipas indikacioneve shëndetësore:  
TIBC, UIBC, yndyrat e gjakut (kolesteroli, HDL dhe LDL kolesteroli, trigliceridet), proteinat;
- 2) Grupi i gjakut dhe faktori Rh – sipas indikacioneve shëndetësore;
- 3) Spirometri e vogël - PEF;
- 4) Eho kardiografia për fëmijët dhe atletët e kategorisë kombëtare, e më vonë sipas indikacioneve;
- 5) Ekzaminimet psikologjike: testimi psikologjik i detyrueshëm për 2 vjet në moshën prej 12 - 18 vjeç për të gjitha ekipet kombëtare, dhe në përputhje me kërkesat e caktuara të përzgjedhësit / trajnerit kombëtar / klubit;
- 6) Ekzaminimi neurologjik;
- 7) Ngarkesa në ergocikël ose tredmill me përcjellje të vazhdueshme EKG të monitorimit; një herë në vit dhe sipas indikacioneve shëndetësore;
- 8) Ekzaminimi Gjinekologjik i atleteve - sipas indikacioneve shëndetësore;
- 9) Antropometri e zgjeruar: BMI, përqindja e yndyrës trupore, përqindja e muskujve. Matjet antropometrike mund të zgjerohen në relacion me kërkesat e disiplinave sportive dhe nevojat e përdoruesve;
- 10) Ekzaminim Radiologjik dhe me fotografim ultrazë: skanim ultrazë, skanim rendgen, CT, EEG dhe MRI sipas indikacioneve shëndetësore;
- 11) Testime të tjera janë të nevojshme për të vlerësuar aftësitë shëndetësore të sportistëve sipas indikacioneve shëndetësore.

#### Neni 21

Rezultatet e kontrolleve të tjera shëndetësore (fotografime dhe konstatimet), sidomos pas lëndimeve sportive, duhet të jenë të bashkangjitura dokumentacionin shëndetësor të atletit.

#### Neni 22.

Bazuar në ekzaminimin shëndetësor:

- 1) Jepet një vlerësim i gjendjes shëndetësore dhe aftësive fizike;
- 2) të dhënat nga vlerësimi do të regjistrohen në dokumentacionin shëndetësor;
- 3) shënohet vlerësimi në librezën garuese;
- 4) Hartohet një raport për atletin, komisionin shëndetësor dhe mjekun e klubit;
- 5) Shifrohen sëmundjet e vërtetuara dhe abnormalitetet sipas MKB dhe propozohen masat e duhura.

#### Neni 23

Përcaktimi i aftësisë shëndetësore të atletit garues përfshin vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe propozimin e masave për të ruajtur shëndetin e atletëve.

Vlerësimet e aftësisë për të marrë pjesë në garat sportive në kuadër të disiplinave të caktuara janë:

- 1) i aftë,
- 2) i aftë me kufizimet vijuese,
- 3) përkohësisht i paaftë,
- 4) i paaftë për disiplinën atletike të propozuar,
- 5) i paaftë,
- 6) vlerësimi dhe opinion nuk mund të jepet për shkak të ...

Vlerësimin e nënshkruan mjeku i certifikuar dhe e vërteton me faksimilin dhe vulën e institucionit të autorizuar shëndetësor ku është kryer ekzaminimi.

Vlerësimi i rezultateve të vlerësimeve psikologjike e nënshkruan dhe e vërteton psikologu i certifikuar i institucionit shëndetësor ku është kryer ekzaminimi.

Vlerësimi jepet menjëherë pas ekzaminimit, e më së voni në afat prej 10 ditësh. Vlerësimi shënohet në dokumentacionin shëndetësor të sportistit garues, dhe në librezën garuese.

#### Neni 24

Kostoja (shpenzimet) e vërtetimit të aftësive shëndetësore të sportistit garues për të marrë pjesë në garat sportive i bart atleti garues ose klubi.

### **Organizimi i kujdesit shëndetësor në gara**

#### Neni 25

Punëtari shëndetësor kujdestar në gara duhet të jetë i licencuar dhe duhet të jetë i deleguar nga komisioni Shëndetësor i Federatës Atletikës të Kosovës, kurse i zgjedhur nga organizatori i garës. Mjeku kujdestar duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së garës.

#### Neni 26.

Tavolina shëndetësore (të paktën një) duhet të jetë në pozicionuar për të lejuar qasje të lehtë dhe të pakufizuar në ambientet dhe tek atletët. Kjo zonë duhet të jetë e pa penguar nga njerëzit tjerë.

#### Neni 27

Organizatori i garës për kohëzgjatjen e garës ofron një automjet për transportin e të lënduarve dhe të sëmurëve.



#### Neni 28

Përmbajtja e pajisjeve, barnave dhe mjeteve mjekësore, për çdo pjesëmarrjes në gara, duhet të specifikohet nga komisioni Shëndetësor i FAK-ut, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

#### Neni 29.

Kontrollin e gjendjes së kujdesit shëndetësor e kryen delegati i garës.

#### Neni 30

Në rast të lëndimit apo sëmundjes gjatë vetë garës, mjeku kujdestar është i obliguar të japë ndihmën e parë në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës.

#### Neni 31.

Punëtori shëndetësor i deleguar ka për detyrë të regjistroj të gjitha lëndimet dhe sëmundjet e shkaktuara në garë, dhe në fund të garës, të paraqesë një raport mbi lëndimet dhe sëmundjet dhe një listë të lëndimeve të nënshkruar dhe vulosur me faksimil dhe ti dorëzoj Komisionit Shëndetësor, brenda 3 ditëve pas garës. Lista e lëndimeve është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje dhe është e vendosur në formularin nr. 2.

### **Kontrolli i dopingut**

#### Neni 32

Dhënia dhe marrja e substancave doping është rreptësisht e ndaluar.

#### Neni 33.

Nëse kontrolli i dopingut është i paraparë me rregullore të garave, punonjësi shëndetësor i deleguar me organizatorin e garës është i detyruar të kryejë të gjithë punën përgatitore në përputhje me rregulloret mbi kontrollin e Anti-Doping për Komisionin antidoping të FAK-ut.

#### Neni 34

Garuesi i cili nuk i përgjigjet kontrollit të anti-dopingut, në të cilin është thirrur në mënyrë të rregullt, do të konsiderohet pozitiv, do të diskualifikohet dhe kundër tij do të zbatohet procedurë disiplinore. Një person i cili pengon atletë t'i nënshtrohen kontrollit anti-doping, të marrin pjesë si ofrim i mjeteve anti-doping ose mbështet atletët në këtë drejtim, do t'i shqiptohet një pezullim automatik.

#### Neni 35

Mjeku i cili, gjatë ekzaminimit të atletit garues, dyshon se atleti ka përdorur substanca doping, ose secili person tjetër i angazhuar në FAK është i detyruar të informojë Komisionin Anti-Doping të FAK-ut.

### **Komisioni Shëndetësor**

#### Neni 36.

Komisioni shëndetësor ka 3 anëtarë. Komisioni shëndetësor do të emërohet me propozimin e anëtarëve të bordit të FAK-ut.

#### Neni 37.

Komisioni shëndetësor kryen detyrat e mëposhtme:

- propozon ndryshimet dhe plotësimet e rregullores së shëndetit,
- propozon Bordit të FAK-ut kryetarin e Komisionit Shëndetësor,
- propozon Bordit të FAK-ut planin e punës,
- delegon punëtorët shëndetësor për gara,
- organizon udhëheqjen e administratës në bashkëpunim me Zyrën e FAK-ut,
- organizon trajnim të vazhdueshëm në marrëveshje me komisionin profesional të FAK-ut
- Drejtpërdrejt bashkëpunon me organizata tjera profesionale dhe institucione shkencore,
- përcakton instruktorët dhe ligjëruesit në seminare,
- nxjerrë literaturë profesionale dhe publikime,
- merr pjesë në organizimin dhe zbatimin e licencimit të mjekëve dhe personelit tjetër mjekësor,
- bënë interpretimin e rregullores së shëndetit,
- në mënyrë aktive bashkëpunon me organizata të tjera të Federatës,
- përcjellë ndryshimet që përcaktohen nga organizatat shëndetësore dhe institucionet,
- puna e saj e kryhen në bashkëpunim me sekretarin gjeneral të FAK-ut.

#### Neni 38

Komisioni shëndetësor mbledhet sipas nevojës.

#### Neni 39

Mbledhjet e komisionit shëndetësor i thërret kryetari i komisionit shëndetësor apo Sekretari gjeneral i FAK-ut.

#### Neni 40

Komisioni shëndetësor do të marrë vendime të vlefshme nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve, dhe vendimet janë të vlefshme në qoftë se ato janë votuar nga më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

### ***Dispozitat Financiare***

#### Neni 41

Bordi i FAK-ut në propozim të komisionit shëndetësor të FAK-ut përcakton shpenzimet për punëtorët e deleguar mjekësor në fillim të çdo viti kalendarik.

### ***Transparenca e punës***

#### Neni 42

Puna e Komisionit Shëndetësor të FAK-ut është publike. Transparenca është reflektuar në zbatimin e kësaj Rregulloreje për të cilat paraqiten raportet për bordin e FAK-ut.

### ***Dispozitat përfundimtare***

Neni 43.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje do të bëhet në bazë të procedurës së ndjekur në nxjerrjen e saj.

Neni 44.

Të gjitha interpretimet e kësaj Rregulloreje i jep Komisioni shëndetësor i dhe Bordi i FAK-ut.

Neni 45.

Kjo rregullore e ka miratuar Bordi i Federatës Atletike të Kosovës në mbledhjen e mbajtur të datës 16.01.2016 dhe do të hyjë në fuqi në datën e miratimit.

Prishtinë  
16.01.2016

Kryetari i FAK-ut  
Halil Sylejmani